



Proçesverbal i Takimit të 15-të të Grupit të Aktorëve
për
Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

16 Dhjetor, 2016
Bashkia Devoll, Bilisht
Republika e Shqipërisë



Pjesëmarrësit në takim:

Struktura e pjesëmarrësve në takimin e 15-të të Grupit të Aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” ka përfshirë 34 pjesëmarrës nga Rajoni i Prespës. Takimi u organizua dhe u lehtësua nga Stafii i Njësise së Menaxhimit të Projektit me asistencën e Presidentes dhe Zëvendës-Presidentit të Grupit të Palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar “Prespa”.

Lista e plotë e pjesëmarrësve dhe detaje për kontaktet e tyre mund të gjenden në:
ANNEX 1: Lista e pjesëmarrësve të takimit të 15-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 16.12.2016

ANNEX 2: PPP_Prespa arritjet dhe rezultatet Shtator 2016 – Dhjetor 2016

Programi i takimit:

Takimit i 15-të i Grupit të Aktorëve Për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

- | | |
|---------------|--|
| 10:00 – 10:30 | Mbërritja e pjesëmarrësve dhe takimi i mirësearchjes |
| 10:30 – 10:45 | Fjalimi i mirësearchjes
Z. Bledjon Nallbati, Kryetar i Bashkisë Devoll
Znj. Viola Bogdani, President i Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”
Z. Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”
Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa” |
| 10:45 – 10:50 | Prezantimi i programit
Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa” |
| 11:50 – 11:30 | Diskutim rreth aktiviteteve “Njerëzit për Njerëzit” në rajonin Ndërkufitar “Prespa”
Arritjet e aktiviteteve të përfunduara dhe para aprovuara “Njerëzit për Njerëzit”: <ul style="list-style-type: none">- Festa e Mollës Korcë- Forumi i Biznesit Prespa- Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Korcë- Organizata DMO Korcë Znj. Etleva Thimo, Koordinatorë Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”
Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa” |



- 11:30 – 11:50 Pushim kafe
- 11:50 – 12:10 Arritjet e përgjithshme dhe aktivitetet e ardhshme në lidhje me zbatimin e ABDA në Rajonin Nderkufitar “Prespa” (periudha Shtator 2016 – Dhjetor 2016)
Diskutimi rreth thirrjeve për projekt propozime të ardhshme dhe të përfunduara në rajonin ndërkufitar "Prespa" dhe një përmbledhje e IPA CBC
Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”
Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”
- 12:10 – 12:30 Sesion informues rreth arritjeve të Thirrjes së Dytë të Skemës së Grantit ABD brenda projektit LEIËË
Z. Darko Buzarovski, Oficer terreni për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”
- 12:30 – 13:00 Konkluzionet dhe aktivitetet e ardhshme
- 13:00 – 14:30 Dreka
- 14:30 Kthimi

Procesverbali i takimit

Takimi u hap me fjalën e mirëseardhjes të nën kryetarit të Bashkisë Devoll Z. Sokol Hoxha. Në emër të Bashkisë, ai falenderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për organizmin e takimit të 15-të të grupit të aktorëve për herë të parë në Bashkinë e Devollit.

Më pas Z.Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" përshendeti të gjithë pjesëmarrësit duke theksuar rëndësinë e takimeve të tilla dhe vazhdimin e bashkëpunimit të suksesshëm me të gjithë grupin e aktorëve.

Në emër të Ambasadës Maqedonase në Shqipëri foli Znj. Anita Nichoska, këshilltare në Ambasadën Maqedonase në Tiranë e cila përshëndeti pjesëmarrësit dhe nënvizoi rëndësinë e aktiviteteve të tilla të rëndësishme në rajonin ndërkufitar Prespa. Ajo shprehu mbështetjen maksimale të Ambasadës Maqedonase në Tiranë për një bashkëpunim edhe në të ardhmen me grupin e antarëve Prespa në organizmin e aktiviteteve të përbashkëta ndërkufitare.

Në vazhdim, Znj. Bojana Jovanovska Menaxhere Rajonale për rajonin ndërkufitar "Prespa" falenderoi për mikëpritjen e takimit të 15-të Bashkinë e Devollit, si edhe gjithë pjesëmarrësit për prezencën dhe uroi një bashkëpunim të frutshëm në vazhdim. Më pas ajo prezantoi në detaje programin e takimit duke u ndalur në çdo sesion të programit dhe çështjeve për tu trajtuar



Sesioni 1

Diskutim rreth aktiviteteve “Njerëzit për Njerëzit” në rajonin Ndërkufitar “Prespa”

Arritjet e aktiviteteve të përfunduara dhe para aprovuara “Njerëzit për Njerëzit”

Seanca filloi me prezantimin e Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për rajonin ndërkufitar "Prespa", e cila bëri një prezantim të aktiviteteve të realizuara nën programin Njerëzit për Njerëzit si edhe të aktiviteteve të para aprovuara. Gjatë prezantimit, ajo falenderoi organizatorët dhe partnerët e përfshirë në organizimin e suksesshëm të aktiviteteve të fundit të mbështetura nën programin Njerëzit për Njerëzit “Festës së Mollës në Korçë” dhe “Formumit të biznesit të Prespës 2016” si edhe ftoi organizatorët për një prezantim përmbledhës të arritjeve dhe organizimit të eventeve.

Në lidhje me aktivitetet e para aprovuara, drejtori i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë Korçë bëri një prezantim të eventit të sugjeruar edhe më parë mbi organizimin e një seminari dhe vizite studimore të përbashkët për ndarjen e eksperiencave rreth krijimit dhe funksionimit të kooperativave bujqësore në rajonin e Prespës. Kështu, gjatë prezantimit të tij ai u fokusua tek situata në rajon duke theksuar rëndësinë e organizimit të një eventit të tillë sidomos për rajonin e Korçës ku procesi është ende në vazhdim ndërsa në bashkinë e Resnjës është ndërmarrë një progres në lidhje me funksionimin dhe krijimin e tyre. Ky event do të ndihmojë personelin e Drejtorisë Rajonale të Korçës të zhvillojë dhe ndajë eksperiencën, por gjithashtu do të ndihmojë fermerët të krijojnë bashkëpunime të mundshme në rajon si edhe të shkëmbejnë eksepiancat e tyre.

Gjatë diskutimit të hapur rreth organizimit të aktivitetit, përfaqësues të Bashkisë Resnjës mbështetën idenë e sugjeruar dhe lehtësimin e partneriteteve për organizimin e eventit me kooperativen bujqësore në Resnjë. Gjithashtu drejtori i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë Korçë konfirmoi se pas konsultimit me personelin dhe fermeret ata do të dorëzojnë draft axhendën e eventit deri në Dhjetor 2016. Eventit është planifikuar të organizohet në Maqedoni në muajin Mars 2017. Gjithashtu u ra dakort që stafi i SWG do të mbështesë Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë në organizimin e eventit, sidomos për lehtësimin e çështjeve logjistike. Gjithashtu, u ra dakort që organizuesit e të gjitha eventeve të para aprovuara të dërgojnë draft aplikimet për organizimin e eventeve tek Zyra e Menaxhimit të Projektit deri në fund të muajit Dhjetor 2016.

Në lidhje me aktivitetet e ardhshme, presidenti i organizatës Muzicka Mladina, Z. Ljupco Krstevski, sugjeroi organizimin e një seminari rreth rrjetëzimit të subjekteve të interesuara në menaxhimin e mbetjeve organike, demonstrim në terren dhe shkëmbim eksperiencash mes palëve të interesuara në rajonin ndërkufitar. Gjithashtu draft aplikimi do të dërgohet tek Zyra për Menaxhimin e Projektit deri në fund të muajit Dhjetor 2016.

Në vazhdim të sesionit prezantime u realizuan në lidhje me aktivitete të përfunduara dhe mbështetura nën programin Njerëzit për Njerëzit. Kështu, Z. Tomi Pikuli bëri një prezantim të përgjithshëm në lidhje me organizimin e eventit “Festa e Mollës Korçë



2016". Aktiviteti u organizua në datën 2 Tetor 2016 në Dvoran, Korçë, nga organizata AgriNet në partneritet me Bashkinë Korçë dhe Resnjë. Qëllimi i këtij eventi ishte që pjesëmarrësit të ndanin eksperiencat, metodologjitë rreth procesit të prodhimit të mollës, praktikat pozitive, përdorimit optimal të pesticideve në prodhimin e mollës, krijimin e rrjetëzimit të partnerëve si edhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet qeverisjes vendore të Resnjës dhe Korçës.

Në vazhdim, në emër të Bashkisë Resnjë, Z.Naume Tashovski ndau me pjesëmarrësit një informacion të përgjithshëm mbi organizimin e aktivitetit të aprovuar nën mbështetjen e programit Njerëzit për Njerëzit, eventin "Forumi i Biznesit Prespa". Aktiviteti u organizua nga Bashkia Resnjë në partneritet me bashkitë Pustec dhe Korçë në datat 1 dhe 2 Dhjetor 2016 në Otesevo, Maqedoni. Qëllimi kryesor i aktivitetit rajonal ishte krijimi i mundësive për bashkëpunim më të gjërë në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë ushimore si edhe të iniciante përfitime ekonomike për popullsinë lokale në rajonin ndërkufitar të Prespës. Prezantimet gjatë Forumit u fokusuan në situatën ekonomike, kapacitetet dhe mundësitë në tre bashkitë e rajonit ndërkufitar të Prespës dhe u mbajtën nga përfaqësues të sektorit të biznesit dhe bashkive. Pjesëmarrësit kishin mundësinë të zhvillonin takime me bizneset dhe të propozonin masa dhe aktivitete të cilat u reflektuan në konkluzionet e nxjerra për veprime në të ardhmen. Dita e dytë e eventit ju dedikua një vizite studimore, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të vizitonin dy kompani prodhuese. Gjithashtu takime mes bizneseve u organizuan me qëllim vendosjen e bashkëpunimeve të mundshme mes pjesëmarrësve.

Sesioni 2

Arritjet e përgjithshme dhe aktivitetet e ardhshme në lidhje me zbatimin e ABDA në

Rajonin Nderkufitar "Prespa" (periudha Shtator 2016 – Dhjetor 2016)

Diskutimi rreth thirrjeve për projekt propozime të ardhshme dhe të përfunduara në rajonin ndërkufitar "Prespa" dhe një përmbledhje e IPA CBC

Sesioni filloi me prezantimin e Znj. Etleva Thimo Koordinatore Rajonale për rajonin ndërkufitar "Prespa", e cila bëri një prezantim ku pasqyroi aktivitetet e kryera dhe arritjet e përgjithshme të zbatimit ABDA për periudhën Shtator 2016 – Dhjetor 2016. Prezantimi u fokusua në ecurinë dhe detajet e veprimeve të ndërmarra në tre mujorin e fundit, arritjeve të përgjithshme, informimin për mbështetjen dhe konsulencën e grupit të palëve të interesuara në përgatitjen e projekt propozimeve. Gjithashtu gjatë prezantimit u dha një përmbledhje rreth thirrjes IPA CBC Shqipëri-Maqedoni 2014-2020 e cila u mbyll në Nëntor 2016. Në këtë kontekst 4 aplikime janë dorëzuar në të cilat antarët e grupit të palëve të interesuara kanë qënë një nga pjesëmarrësit aplikues. Në përfundim të prezantimit u vazhdua në një diskutim të hapur me pjesëmarrësit dhe rahjen e mendimeve për aktivitete të ardhshme në rajonin e Prespës.

Gjatë diskutimit antarët e grupit të palëve të interesuara u inkurajuan të zhvillojnë dhe ti dërgojnë Zyrës për Menaxhimin e Projektit ide të mëtejshme për organizimin e



mundshëm të eventeve rajonale në rajonin e Prespës. Gjithashtu gjatë diskutimeve rreth përgatitjes së projekt propozimeve përfaqësues të Bashkisë Resnjë, organizatës AgriNet dhe Parkut Kombëtar Pelister dhanë një përmbledhje të përgjithshme të aplikimeve të dorëzuara nën programin IPA Shqipëri – Maqedoni 2014-2020.

Diskutimet konkluduan se Njësia për Menaxhimin e Projektit dhe SWG do të vazhdojnë të shërbejnë si një pikë informuese ku antarë të grupit të palëve të interesuara do të marrin informacionin e nevojshëm për programe dhe thirrje për aplikime të reja. Faqja zyrtare e internetit (web) aktive, faqja e Facebook për rajonin ndërkufitar Prespa si edhe faqja e re zyrtare e internet për ABDA do të pasurohen me informacion relevant me qëllim rritjen e vizibilitetit dhe promovimin e punës të grupit të palëve të interesuara në rajon. Gjithashtu antarët e grupit të palëve të interesuara u inkurajuan të dërgojnë informacione relevante tek Njësia për Menaxhimin e Projektit me qëllim ndarjen dhe rritjen e ndërgjegjësimit për veprime dhe aktivitete të zbatuara në rajon. Njësia për Menaxhimin e Projektit do të vazhdojë të mbështesë përgatitjen e aplikimeve për thirrje të ndryshme si edhe do lehtësojë partneritete të mundshme për thirrje aktive të programeve IPA CBC në rajon. Gjithashtu, Njësia për Menaxhimin e Projektit do të vazhdojë të targetojë dhe lehtësojë rrjetëzimin midis palëve të interesuara publike dhe private për të aplikuar në thirrjen e mësipërme si edhe në thirrje të tjera të ndryshme.

Një nga antarët e grupit sugjeroi se duke mos vënë në pikëpyetje punën e bërë deri tani nga presidenca e grupit të palëve të interesuara, grupi duhet të konsiderojë rotacionin e ardhshëm të presidencës. Kjo u sugjerua ndërkohë që edhe Protokollin Operacional është tashmë miratuar dhe se ky rifreskim i grupit do të jetë motivues dhe produktiv për antarët.

Sesioni 3

Sesion informues rreth arritjeve të Thirrjes së Dytë të Skemës së Grantit ABD brenda projektit LEIWW

Sesioni filloi me prezantimin e Z. Darko Buzarovski, Oficer Terreni për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”. Prezantimi u fokusua në pasqyrimin përmbledhës së Skemës së dytë të Grantit ABDA për zhvillimin e integruar ekonomik. Në vazhdim informacion i përgjithshëm u nda në lidhje me arritjet e përgjithshme të thirrjes së dytë të Skemës së Grantit në rajonin Prespa. Thirrja e dytë të Skemës Grantit ABD në rajonin ndërkufitar Prespa, zyrtarisht u mbyll në datën 5 Dhjetor 2016 në orën 16:00. Kështu, në krahasim me thirrjen e parë gjatë thirrjes së dytë të Grantit ABDA brenda programit LEIWW interesi, por për më tepër numuri i aplikimeve u rrit ndjeshëm. Gjithashtu, informacion i mëtejshëm u nda në lidhje me procesin e vlerësimit dhe hapat e mëtejshme për tu ndjekur pas dorëzimit të aplikimeve.

Sesioni vazhdoi me një diskutim të hapur për sugjerime dhe komente të mëtejshme. Gjithashtu antarët e grupit të palëve të interesuara u inkurajuan të zhvillojnë dhe ndajnë ide me qëllim përmirësimin dhe rritjen e bashkëpunimit në rajonin ndërkufitar.



Sesioni 4

Konkluzione dhe mbyllja e takimit

Në sesioni e fundit u dhanë konkluzionet si mëposhtë:

- Njësia për menaxhimin e projektit “Prespa” dhe SWG do të shërbejë si një pikë informative ku antarët e grupit (SHG) të marrin informacion e nevojshëm për thirrje të reja për projekt propozime. Ata do të vazhdojnë të mbështesin në përgatitjen e aplikimeve për projekt propozime të ndryshme si edhe do të lehtësojnë partneritetet për programe aktive IPA, CBC në rajon dhe thirrje të tjera të aktive për rajonin;
- Faqja zyrtare aktive e internetit, faqja zyrtare në Facebook si edhe faqja e re zyrtare ABDA për rajonin ndërkufitar Prespa do të përmirësohen vazhdimisht me informacion relevant me qëllim rritjen e vizibilitetit dhe promovimin e punës të grupit të palëve të interesuara në rajon. Gjithashtu, antarë të grupit duhet të dërgojnë informacion relevant pranë Njesisë së Menaxhimit të Projektit me qëllim ndarjen dhe rritjen e ndërgjegjësimit për veprime dhe aktivitete të zbatuara në rajon;
- Njësia për menaxhimin e projektit do të vazhdojë të mbështesë koordinimin e aktiviteteve potenciale dhe zhvillimin e veprimeve të mëtejshme për organizimin e aktiviteteve potenciale (Seminar mbi kooperativat bujqësore në Rajonin e Prespës dhe Menaxhimi organik i mbetjeve) dhe evente të tjera që mund të mbështeten nën programin Njerëzit për Njerëzit;
- Zyrtarisht u deklarua se formati i draft aplikimit për aktivitetet e para aprovuara nën programin Njerëzit për Njerëzit duhet ti dërgohet Njesisë së Menaxhimit të Projektit deri në fund të muajit Dhjetor 2016;
- Grupi i antarëve të palëve të interesuara duhet të marrë parasysh rotacionin e ardhshëm në lidhje me presidencën;
- Grupi i Përhershëm i Punës (SWG) për Zhvillim Rural Rajonal në Evropën Juglindore, në bashkëpunim me GIZ dhe në kuadër të projektit "Zhvillimi Rural përmes menaxhimit të integruar të pyjeve dhe burimeve ujore" (LEIWW), mbylli zyrtarisht Thirrjen për propozime në datën 5 Dhjetor 2016 në orën 16:00;
- Në krahasim me thirrjen e parë, gjatë thirrjes së dytë të Skemës së Grantit ABDA nën projektin LEIWW numuri i aplikimeve dhe ineresi ishte më i madh. Thirrja e re e dytë e Skemës së Grantit ABDA nën projektin LEIWW do të krijojë mundësi shumë të mira për rajonin Prespa për të treguar kapacitetet



potenciale të rajonit dhe gjithashtu të kontribuojë në përmirësimin e zhvillimit të integruar ekonomik të rajonit Prespa.

Përgatiti:

Etleva Thimo

Koordinatorë Rajonale për Rajonin Ndërkufitar të Prespës

